
TË DREJTAT E NJERIUT NË KOHË PANDEMIE

IMPRINT

Botuar nga:
Civil Rights Defenders

Për botuesin:
Goran Miletic

Autorët:
SHARE Foundation

Bojan Perkov
Kristina Cendic
Filip Milosevic
Andrej Petrovski
Milica Jovanovic

Redaktorët
Neda Mirkovic

Punimi grafik:
Marko Kovachevski

TË DREJTAT E NJERIUT NË KOHË PANDEMIE



 CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Të Drejtat e Njeriut në kohë Pandemie
7

Një Panoramë rajonale
8

Përgjigja e shteteve ndaj COVID-19
10

Ndikimi i masave anti-COVID
12

Liria e shprehjes
12

Mbikëqyrja
14

Puna në distancë
16

Problematikat me kapacitetet
17

Këshilla digjitale
18

Komunikim i sigurt
20

Mjete të sigurta për grupe
21

Përfundimi
22

TË DREJTAT E NJERIUT NË KOHË PANDEMIE

Pandemia e COVID-19, krahas rritjes së madhe të trysnive ekzistuese ndaj të drejtave të njeriut dhe mbrojtësve të tyre në të gjithë botën, i përballi komunitetet që tashmë vuajnë nga pabarazitë dhe padrejtësitë në shtetet e tyre me sfida të mëdha, ndaj të cilave u shtuan edhe masat e jashtëzakonshme që u zbatuan nga shumë prej këtyre shteteve për të ndaluar përhapjen e pandemisë. Duke adresuar reagimin e shteteve dhe “dëmet sociale, ekonomike dhe politike të shkaktuara nga COVID-19”, në gusht, Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së i paralajmëroi shtetet që të “informojnë, fuqizojnë dhe të dëgjojnë komunitetet”.¹

Në maj, Drejtori Ekzekutiv i Civil Rights Defenders Anders L. Pettersson u shpreh: “Disa masa mund të jenë të nevojshme, por është e qartë që disa të tjera nuk janë të tilla, dhe të gjitha këto masa duhet të hiqen kur të ketë përfunduar kjo situatë. Për më tepër, përdorimi i pandemisë për të intimiduar mbrojtësit e të drejtave të njeriut apo për të cenuar shtetin e së drejtës për përfitime politike, ashtu siç po dëshmohet, është tërësisht e papranueshme.” Ai gjithashtu theksoi rolin e organizatave të të drejtave të njeriut në procesin e monitorimit dhe kërkimit të llogaridhënies nga autoritetet kur kalohet caku midis asaj që është realisht e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe keqpërdorimit të pushtetit.²

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka pasur përvoja të ngjashme. Ndërkohë që në shumë vende të Ballkanit reagimi ndaj pandemisë u bazua në një pikëpamje ushtarake, çështjet e shëndetit publik hapën rrugën për diskursin e sigurisë shtetërore në kuadër të të cilin opinionet e kundërta dhe ngritja e pikëpyetjeve shihen si shenja kundërshtimi.

Ndërkohë që në disa vende hapësira e zakonshme e medias për kundërshtim është tashmë e kufizuar, pas zbatimit të mbylljeve të plota dhe të pjeshme dhe shtetrrëthimeve, shumica e veprimtarive sociale dhe politike u zhvendosën në hapësirën në internet. Trysnia ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut ndoqi të njëjtin model.

Masat zyrtare të zbatuara me qëllim luftimin e pandemisë, kishin shpesh të bënin me mbikëqyrje të shtuar dhe përdorimin e teknologjisë për gjurmimin e lëvizjeve. Këto rrethana kanë ndikuar gjerësisht privatësinë e punës së bërë nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut në çdo fushë. Gazetarët, avokatët dhe aktivistët e përfshirë me të drejtat e njeriut u përballën edhe me zhvendosjen e veprimtarive të tyre në komunitet, si seminarët, protestat dhe konferencat në hapësirën e internetit, teksa rrekeshin të ruanin sigurinë e komunikimeve të tyre.

Së bashku me marrjen e një kampioni të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe me përshkrimin e prirjeve të dukshme lidhur me kufizimin e punës së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në një sërë vendesh të Evropës Juglindore, ky botim ofron edhe një mundësi për të parë në këndvështrim tjetër ofrimin e shërbimeve në internet dhe instrumentet që përdoren në veprimtarinë e përditshme. Kemi në dispozicion instrumente të sigurt dhe etike digjitale, të cilat mund të zëvendësojnë veprimet e mbledhjes së të dhënave të shumta nga ana e Facebook, Google, Amazon dhe gjigantë të tjetër të teknologjisë së informacionit, dhe që mund të na ndihmojnë t'i shmangemi censurës qeveritare, mbikëqyrjes nga agjencitë e inteligjencës dhe sulmeve nga kriminelët kibernetikë dhe piratët keqdashës.

¹ Fjala hapëse e Drejtorit të Përgjithshëm të OBSH-së në konferencën për shtyp për COVID-19 më 3 gusht 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 3 gusht 2020

² COVID-19 nuk përbën justifikim për abuzim me të drejtat e njeriut nga ana e qeverive, Anders L. Pettersson, The Globe Post, 1 maj 2020.

NJË PANORAMË RAJONALE

Fondacioni SHARE monitoron shkeljet e të drejtave digjitale në Serbi që prej vitit 2014, dhe duke nisur që nga viti i shkuar ka zgjeruar fushëveprimin e vet në partneritet me Rrjetin Ballkanik të Raportimit Investigativ (BIRN) për të gjurmuar incidente të tilla edhe në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Hungari, Maqedoni të Veriut dhe Rumani.³ Baza e të dhënave të monitorimit të të drejtave digjitale e Fondacionit SHARE dhe BIRN-it:

Procesi i monitorimit bazohet në gjurmimin e llojeve të ndryshme të shkeljeve, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar,⁴ duke i klasifikuar rastet në kategori të veçanta. Metodologjia përcakton shtatë kategori të ndryshme të shkeljeve të të drejtave dhe lirive digjitale:

A. Thyerjet e informacionit të sigurisë: raste të thyerjeve të sistemeve të informacionit, si hyrje të paautorizuara, sulme DDoS (Refuzim i Shpërndarë i Shërbimit) me qëllim moslejimin e qasjes në përmbajtje të caktuara, vjedhje dhe shkatërrim të të dhënave, etj.

B. Shkeljet e privatësisë së informacionit dhe të dhënave personale: raste të nxjerrjes së paautorizuar të të dhënave, përpunime të dhënash apo interceptime komunikimesh në mënyrë të jashtëligjshme.

C. Trysni për shkak të shprehjes dhe veprimtarisë në internet: këto shkelje kanë të bëjnë me nderin dhe reputacionin, vënien në rrezik të sigurisë, diskriminimin dhe urrejtjen, lirinë e shprehjes në vendin e punës, dhe trysnitë ndaj individëve për shkak të publikimit të informacionit në internet.

D. Manipulimi dhe propaganda në mjedisin digjital: këto shkelje përfshijnë forma të ndryshme të shpërndarjes së përmbajtjeve dhe manipulimit në internet me qëllim arritjen e synimeve të caktuara, të cilat shpesh janë synime ekonomike.

E. Mbajtja e përgjegjësisë nga ndërmjetësit: këto shkelje kanë të bëjnë me trysninë ndaj ofruesve të internetit, kërkesa për ofruesit e hostimeve dhe ato për fshirjen e përmbajtjeve, si dhe refuzimin e shërbimit, përmes kërcënimit me masa ligjore, ndëshkime, apo përmes bllokimit.

F. Bllokimi dhe filtrimi i përmbajtjeve: në këto raste, përmbajtje të caktuara janë bllokuar me metoda teknike në nivel kombëtar apo institucional, dhe përfshijnë rastet kur algoritmet e platformave bllokojnë apo pezullojnë përmbajtje të ligjshme (si p.sh parodi në video).

G. Të tjera: shkelje të tjera të të drejtave dhe lirive digjitale që nuk përfshihen në kategoritë e përcaktuara më lart.

Përveç kategorive të përmendura më lart, procesi i monitorimit ofron gjithashtu informacion për sulmuesit dhe palët e ndikuara. Ato mund të përfshijnë gazetarë, figura publike, zyrtarë shtetërorë, qytetarë, aktivistë dhe të tjerë. Nëse identifikimi është i mundur, përskrimet e rasteve përfshijnë edhe mënyrën e sulmit. Këto mund të jenë teknike (sulme me ‘malware’, injektim kod kompjuterik, sulme të kërkimit pararojë, sulme interceptimi, sulme aksesi, sulme të mbytyes/refuzimit të shërbimit) ose ligjore (padi private, ankesa penale, arrestime dhe burgime, gjykime me rëndësi të latë, konfiskime dhe kërkime, ankesa për kundërvajtje). Gjithashtu, monitorohen edhe rezultatet e çështjeve, pra monitorimi përmend masat ligjore apo të llojeve të tjera të marra lidhur me çështjen, si dhe nëse është marrë vendim i formës së prerë nga gjykata.

Ky raport paraqet gjetjet për katër vende, përkatësisht Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, dhe Serbi, dhe bazohet në të dhënat e marra gjatë periudhës 31 janar deri 30 nëntor 2020.⁵

³ Baza e të dhënave të monitorimit të të drejtave digjitale e Fondacionit SHARE dhe BIRN-it: <https://monitoring.bird.tools/>

⁴ Për më shumë detaje lidhur me metodologjinë e monitorimit të të drejtave digjitale të Fondacionit SHARE dhe BIRN, vizitoni: <https://monitoring.bird.tools/methodology>

⁵ Ju lutemi vini re: të dhënat për Kosovën janë siguruar nga Rrjeti Ballkanik për Raportimin Investigativ (BIRN), ndërsa të dhënat për Shqipërinë bazohen në informacionin e siguruar nga stafi i CRD-së në Shqipëri dhe në publikimin “E drejta e informacionit gjatë fatkeqësive natyrore në Shqipëri në vitin 2020” me autor Dorian Matlija mbështetur nga stafi i qendrës Res Publica.

KATEGORIA E SHKELJES	Serbia	Bosnje dhe Hercegovina	Shqipëria	Kosova
A. Thyerjet e sigurisë së informacionit	4	1	1	0
B. Shkeljet e privatësisë së informacionit dhe të dhënave personale	8	5	2	4
C. Trysni për shkak të shprehjes dhe veprimtarive në internet	30	9	2	3
D. Manipulimi dhe propaganda në mjedisin digjital	15	6	2	4
E. Mbajtja e përgjegjësisë nga ndërmjetësit	0	1	0	0
F. Bllokimi dhe filtrimi i përmbajtjeve	0	0	1	0
G. Të tjera	0	0	0	0
GJITHSEJ	57	22	8	11

Gjatë periudhës së vëzhgimit, në Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Kosovë janë regjistruar 98 shkelje të të drejtave digjitale lidhur me pandeminë, që shkojnë nga arrestimi i gazetarëve dhe qytetarëve për shkak të informacionit të shpërndarë prej tyre në internet e deri tek sekuestrimi i pajisjeve dhe nxjerrja e paautorizuar e të dhënave personale. Përveç incidenteve të piketuara, është rritur numri i rasteve të përpunimit të papërshtatshëm të të dhënave shëndetësore me ndjeshmëri të qytetarëve dhe të publikimit të paligjshëm të qëllimshëm të këtyre të dhënave.

Lloji më i shpeshtë i shkeljeve gjatë periudhës së vëzhgimit, që përbën rreth gjysmën e të gjitha rasteve të regjistruara, kishte të bënte me trysninë për shkak të shprehjes dhe veprimtarive në internet, si ofendimet, kërcënimet, publikimit të gënjeshtrove me qëllim shpifjen, etj.

Sipas një dokumenti politikash për Ballkanin Perëndimor,⁶ në disa vende, pandemia nxori në pah probleme afatgjata dhe shërbeu si “përshpejtues i prirjeve ekzistuese, si kriza e demokracisë dhe nacionalizmi”. Në raste të tjera, ajo u ndoq nga afër nga fushata zgjedhore që shkaktuan “mosbesim dhe zemëratë kundrejt autoriteteve dhe shtetit, duke nxjerrë në pah mosbesimin e thellë ndaj këtyre të fundit”. Në të gjitha vendet e vëzhguara, liria e shprehjes pësoi rënie.

Gjatë mbylljes, trysnitë politike ndaj sektorëve të medias në këto vende sollën pasoja serioze si centralizimin e informacionit, përhapjen e lajmeve të rreme dhe përndjekjen e atyre që kishin pikëpamje kundërshtuese, qofshin këta gazetarë profesionistë apo amatorë. Në të njëjtën kohë, mediat pranë qeverive nuk e ndaluan përhapjen e lajmeve të rreme nga ana e tyre. Në disa raste, autoritetet kishin pushtet kaq të madh mbi informacionin sa ato u munduan të miratonin legjislacion që do të bënte të jashtëligjshëm çfarëdo informacioni përveç atij zyrtar. Në këtë mënyrë, ato ushtruan pushtetin e tyre dhe penguan edhe më shumë procedurat demokratike në këto vende, duke kufizuar të drejtat e njeriut me pretekstin e luftës kundër pandemisë.

⁶ Dokument Politikash: Ballkani Perëndimor në Periudhën e Pandemisë Botërore, Grupi i Këshillimit për Politikën, Ballkani në Evropë (BiEPAG), prill 2020

PËRGJIGJA E SHTETEVE NDAJ COVID-19

Në mars të vitit 2020, qeveritë e disa vendeve të vëzhguara në këtë raport, shpallën gjendjen e fatkeqësisë natyrore. Në Serbi ajo u shpall më 15 mars dhe zgjati deri më 6 maj; në Bosnje dhe Hercegovinë zgjati nga 15 marsi deri më 29 maj për Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe nga 28 mars deri më 21 maj për Republikën Srpska; dhe në Shqipëri zgjati nga 25 marsi deri më 23 qershor. Në Kosovë hyri në fuqi më 16 mars një gjendje emergjence e shëndetit publik nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë. Qytetarët e të katër vendeve u përballën me kufizime dhe sfida të ngjashme gjatë pandemisë dhe megjithëse të gjitha kufizimet sollën një kundërshtim më të madh publik, aktivizmi për të drejtat e njeriut duhej të mbështetej tek interneti më shumë se kurrë.

Gjendja e fatkeqësisë natyrore në Shqipëri zgjati më shumë se në çdo vend tjetër pjesë e këtij raporti. Autoritetet insistuan te nevoja e mbrojtjes së shëndetit publik, por respektimi i të drejtave të qytetarëve u vu në pikëpyetje, sidomos kur bëhej fjalë për ushtrimin e të drejtës së shprehjes në internet. Gjatë krizës, qeveria pllakosi më fort informacionin, veçanërisht atë lidhur me përhapjen e virusit, çka rezultoi në një sërë shqetësimesh. Diskursi publik përbëhej nga një sërë frazash të përdorura në periudhë lufte, që i shtinin frikën qytetarëve me një sërë mjetesh të blinduara në rrugë.⁷ Ashtu si në shumë vende të tjera, qytetarët e Shqipërisë u hutuan nga masat e marra. Është ngritur një Komitet Teknik Ekspertësh për të marrë vendime lidhur me masat për luftën kundër pandemisë, por “puna e Komitetit u shoqërua me informacion të kufizuar publik lidhur me kompetencat e tij dhe masën e përkthimit të rekomandimeve të tij në vendime politike. Deri në fillim të muajit Maj, edhe emri i kryetarit të Komitetit nuk u bë i ditur”. Në një rast, forca policore shqiptare kundër terrorizmit kërkoi ngritjen e padive penale kundër dhjetë personave, duke deklaruar se ata po përdornin Facebook-un për përhapjen e lajmeve të rreme.⁸

Me sa duket, policia kishte monitoruar postimet dhe komentet në Facebook dhe zbuluan deklaratat përkatëse në këtë çështje. Në Shqipëri, monopolizimi i informacionit u kthye në një nga problemet më serioze me të cilat vendi u përball gjatë krizës. Kryeministri ishte tejet aktiv edhe në mediat sociale, përveç pranisë së tij mbizotëruese në transmetuesin publik. Në fakt u raportua se “vetëm në muajin e parë të mbjlljes, Kryeministri publikoi 407 postime në Facebook (13 në ditë) dhe 47 orë video, duke krijuar kështu përvojën e parë të qeverisjes së Shqipërisë përmes mediave sociale”.⁹ Ishte goxha të vihej re se shumica e vendimeve u publikuan fillimisht në llogarinë e Kryeministrit në Facebook dhe më vonë në Fletoren Zyrtare, ndërsa ‘konferencat për shtyp’ në të vërtetë nuk ishin të hapura për gazetarët.” Kështu, qasja në informacion publik të saktë u pengua, dhe “media kombëtare kishte mundësi të kufizuara për të ofruar informacion shtesë për publikun dhe për të dhënë informacion përtej atij të ofruar nga qeveria.”¹⁰

Bosnj dhe Hercegovina nuk kishte një strategji të qëndrueshme zyrtare për të luftuar pandeminë, për shkak të ndarjeve të saj administrative. Secili nga dy entitetet, përkatësisht Federata e Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska, Distrikti i Brcko i Bosnje dhe Hercegovinës dhe dhjetë kantonet në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës morën masa të ndryshme për frenimin e pandemisë. Një situatë e tillë ishte veçanërisht e koklavitur për qytetarët e Sarajevës, duke qenë se kufiri midis entiteteve përshkon qytetin dhe kufizimet dhe masat përkatëse ndryshonin nga rruga në rrugë.¹¹ Gjatë krizës, publiku në Bosnje dhe Hercegovinë, përfshirë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, u përball me problematika të keqinformimit lidhur me barnat që po prodhoheshin në vend, mungesën e testeve, avionë që po spërkatnin qytetet me virus, etj. Gjithashtu, edhe mbrojtja e të dhënave personale hasi probleme: autoritetet bënë publik emrat e atyre që nuk i bindeshin urdhrave të vetëizolimit dhe u mor në konsideratë edhe bërja publike e personave të infektuar. Autoritetet e Konjic dhe Kantonit 10 bënë publike të dhënat personale të personave në vetëizolim dhe më pas i fshinë ato pasi Agjencia e Mbrojtjes së të Dhënave deklaroi që kjo ishte shkelje.¹² Goditja më e madhe kundër të drejtave të njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë u vërtetua kur entiteti i Republikës Srpska miratoi një vendim që ndalonte përhapjen e panikut dhe trazirave përmes lajmeve të konsideruara të rreme.¹³ Pasi u kritikua si e dëmshme për lirinë e shprehjes nga mbrojtësit vendas dhe ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, vendimi i la mënjanë shpejt, por vetëm pasi një sërë qytetarësh i shin arrestuar apo gjobitur.

7 G. Madhi, Shqipëria: informacioni publik bie viktimë e COVID-19, OBC Transeuropa, 11 qershor 2020

8 G. Emiri, Lufta Shqiptare kundër 'Përhapësve të Panikut' Krijon Mosbesim tek Aktivistët e të Drejtave, BIRN, 29 korrik 2020

9 G. Madhi, Shqipëri: informacion publik bie viktimë e COVID-19, OBC Transeuropa, 11 qershor 2020

10 Po aty.

11 G. Sandić-Hadžihanović, Entitetet dhe pandemia: Në njërin anë të rrugës një rregull, në anën tjetër një tjetër, Radio Free Europe/Radio Liberty, 14 maj 2020

12 Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi duhet të respektojnë të drejtën e privatësisë së qytetarëve në vetëizolim, CRD, 25 mars 2020

13 M. Milojević, Parandalimi i përhapjes së panikut ose 'disiplinimi' i mjekëve dhe gazetarëve, Radio Free Europe/Radio Liberty, 12 prill 2020

Përveç pandemisë, Kosova u përball edhe me një krizë politike, sepse qeveria pësoi një votë mosbesimi, që kontribuoi më tej në pasigurinë dhe mosbesimin e përgjithshëm të qytetarëve. Po ashtu si në vende të tjera, autoritetet këmbëngulën që njerëzit të mbanin maska, të distancoheshin fizikisht, si dhe zbatuan kufizime të lëvizjes. Sa i përket këtyre të fundit, BIRN Kosovë dhe një shoqëri vendore programimi KUTIA, krijuan një platformë të quajtur “90 minutëshi yt”, që u mundësonte qytetarëve të kontrollonin në cilën orë lejoheshin të dilnin nga shtëpitë e tyre, duke shtypur shifrat e fundit të numrit të letërnjoftimit të tyre, apo shifrat e pasaportës.¹⁴ Megjithatë, gjatë krizës, qytetarët ishin shumë më të shqetësuar me efektin drithërues të shkaktuar nga arrestimet e atyre që shpreheshin për çështje të interesit publik. Një redaktor nga Mitrovica u arrestua, çka vuri lirinë e shprehjes nën trysni të madhe.¹⁵ Efekti drithërues në Kosovë u shtua më tej kur policia e Kosovës vendosi të përndjekë penalisht një person që dyshohej të kishte shpërndarë një mesazh që i ftonte qytetarët të bënin testin për koronavirusin në Qendrën Klinike të Universitetit të Kosovës (UCCK), me pretendimin se disa grupe të caktuara gjaku ishin me të prirura të merrnin sëmundjen.¹⁶ Për më tepër, portali i lajmeve Sinjali, botoi emrat, adresat dhe datëlindjet e 210 qytetarëve në karantinë në Mitrovicën e Veriut dhe qytete të tjera, që u vlerësua si shkelje e privatësisë.¹⁷ Pas një reagimi të fortë nga Shoqata e Gazetarëve Serbë në Kosovë dhe nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, të dhënat personale u bënë të palexueshme.

Në Serbi, shpërthimi i Covid-19 dhe shpallja e gjendjes së emergjencës rezultoi në marrjen e masave problematike nga ana e autoriteteve, me qëllim luftimin e pandemisë. Kjo mund të shihet në përpjekjet për të kontrolluar rrjedhën e informacionit, duke i dhënë përparësi mediave përkrahëse të qeverisë, në armiqësinë ndaj mediave të pavarura dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe në shkeljet e mbrojtjes së të dhënave personale. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, aktorë të ndryshëm i transferuan veprimtaritë e tyre në internet më shumë se kurdoherë, çka i bëri ata edhe më të cenueshëm nga kërcënimet dhe sulmet digjitale. Një nga incidentet më serioze pati të bënte me një nxjerrje të dhënash që ndodhi kur kredencialet e hyrjes për sistemin e informacionit të Covid-19 u hodhën publikisht në internet.¹⁸

Këto kredenciale që përdorshin për të hyrë në sistemin që përpunonte të dhënat e ndjeshme të qytetarëve lidhur me pandeminë, ishin të disponueshme publikisht në faqen e internetit të një institucioni shëndetësor për një periudhë 8 ditore. Megjithëse emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi u hoqën pasi shoqëria civile lajmëroi autoritetet, tetë ditë ishin të mjaftueshme që Google të indeksonte informacionin dhe ta bënte atë të disponueshëm në rezultatet e veta të kërkimit. Për më tepër, qeveria serbe u mundua të centralizonte informacionin për pandeminë duke miratuar një vendim që thoshte se vetëm informacioni që jepej nga autoritetet ishte i besueshëm, duke pretenduar kështu se të gjitha burimet e tjera ishin lajme të rreme. Gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile, si edhe qytetarë që flisnin për problematika si mungesa e pajisjeve mjekësore, mungesa e karburantit, etj. u akuzuan për përhapje paniku dhe disa prej tyre u arrestuan.

14 S. Todorović, Platforma e BIRN për të Ndhimuar Kosovarët të Ndjekin Kufizimet e COVID-19, BIRD, 16 prill 2020

15 Përfaqësuesi i Lirisë së Mediave të OSBE-së i shqetësuar për trysinë mbi portalin online KoSsev dhe kryeredaktorin e tij në Kosovë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 12 prill 2020

16 Thirrje për testim për koronavirus me mesazhe të rreme, Kosovo online, 31 mars 2020

17 COVID-19: ndërhyrja politike në media në Kosovë, European Federation of Journalist, 4 prill 2020

18 Një pandemi me fjalëkalime. Si përfundoi online fjalëkalimi i COVID-297, SHARE Foundation, 24 prill 2020

Ndikimi i masave anti-COVID

LIRIA E SHPREHJES

Pandemia pati një ndikim të konsiderueshëm mbi lirinë e shprehjes në mbarë botën. Kur shëndeti publik është në rrezik dhe kur vendet shpallin gjendjen e jashtëzakonshme, mund të vendosen disa kufizime kundrejt qytetarëve, megjithatë masat nuk mund të jenë të tepruara. Sipas nenit 19, duket se shumë qeveri kanë përdorur pandeminë për të mishëruar më tej masa shtypëse dhe për të kufizuar liritë e shprehjes dhe të informacionit.¹⁹ Vendet e Ballkanit Perëndimor vunë në zbatim kufizime që kanë kërcënuar lirinë e shprehjes dhe kanë ndikuar tej mase në punën e aktivistëve dhe gazetarëve.



Teknologjitë digjitale ndryshuan mënyrën se si ushtrime të drejtën tonë të shprehjes dhe i mundësuan aktorëve të ndryshëm të ndërmarin edhe rolin e gazetarit. Kështu, gjithmonë e më shumë mbështetemi në terma si aktorë të medias dhe gazetarë qytetarë, që të gjithë marrin pjesë në diskutime për çështje të interesit publik. Gjithmonë e më shumë, pandemia i transferoi këto diskutime në mjedisin në internet, por së bashku me këtë transferim erdhi edhe një intensifikim i trysnisë në internet kundrejt atyre që ushtronin lirinë e tyre të shprehjes ose që raportnin mbi çështje të interesit publik. Gazetarët profesionistë dhe aktorë të tjerë të medias tradicionale nuk janë të vetmit që janë në shënjestër. Sipas Kombeve të Bashkuara, në Planin e vet të Veprimtimit për Sigurinë e Gazetarëve dhe Çështjet e Mosndëshkimit, dhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut në Komentin e vet të Përgjithshëm Nr. 34 “përkufizimi i ‘aktorë të medias’ është zgjeruar si pasojë e formave të reja të medias në epokën digjitale. Kështu që, ai përfshin të tjerë që japin kontribut në debatin publik dhe që kryejnë veprimtari gazetarie ose përmeshin funksionin e mbikëqyrësve publikë.”²⁰ Megjithatë, në Ballkanin Perëndimor kemi qenë dëshmitarë të kërcënimeve dhe ofendimeve të drejtuara ndaj atyre që u shprehën kundër informacionit të dhënë nga zyrtarët, apo që shprehën pikëpamjet e tyre lidhur me pandeminë, ndërsa në disa rastet pati edhe arrestime apo gjobitje.

19 Koronavirusi: Ndikimet në lirinë e shprehjes, Neni 19

20 Rekomandimi KM / Rec (2016) për vendet anëtare për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias, Këshilli i Evropës, 13 prill 2016

Një nga hapat e parë që disa nga vendet morën pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme ishte të kontrollonin rrjedhën e informacionit. Publiku ka të drejtë jo vetëm të ushtrijë lirinë e vet të shprehjes, por edhe të marrë informacion. Megjithatë, më 28 mars, Qeveria e Serbisë i ndaloi çdokujt që nuk ishte pjesë e Stafit të Krizës të jepte informacion për pandeminë, duke shpallur se i gjithë informacioni nga burime të tjera do të trajtohej si i pasaktë dhe i paverifikuar. Më konkretisht, nëse ky informacion shpërndahej, atëherë personi në fjalë mund të ishte përgjegjës dhe të vuante pasojat ligjore për përhapje keqinformimi gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.²¹ Kemi vënë re situata të ngjashme në Bosnje dhe Hercegovinë, kur entiteti i Republikës Srpska miratoi një vendim që ndalonte përhapjen e panikut dhe trazirave, përfshirë përmes rrjeteve sociale dhe mediave.²² Ky vendim dëmtoi ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes, kështu që mbrojtësit vendorë të të drejtave të njeriut, si dhe aktorët ndërkombëtarë bënë thirrje që ky vendim të shfuqizohej sa më shpejt të ishte e mundur. Vendimi i hoq shpejt mënjane, por derisa kjo ndodhi, kishte qytetarë që ishin arrestuar apo gjobitur. Gjobat e lëshuara për shkeljen e këtij vendimi ishin në vlerë nga 500 deri 1.500 Euro për personat fizikë dhe nga 1.500 deri 4.500 Euro për personat juridikë.

Një nga rastet më serioze që shkaktoi efekte drithëruese ishte ai i Ana Lalic, një gazetare që u arrestua për artikullin e saj lidhur me gjendjen e spitaleve në Novi Sad në Serbi. Ana u arrestua më 1 prill, vetëm disa orë pasi artikulli i saj me titull “Qendra Klinike e Vojvodinës në gjendje të rëndë: Nuk ka mbrojtje për infermierët” u botua. Në artikull ajo trajtonte çështje të interesit publik, si mungesa e mjeteve mbrojtëse si maska dhe doreza në Qendrën Klinike të Vojvodinës. Spitali ngrii një ankesë kundër saj duke deklaruar se artikulli dëmtonte reputacionin e tij dhe shqetësonte publikun me informacion të paverifikuar. Pas arrestimit të Anës, laptopi dhe telefoni i saj u konfiskuan dhe ajo u vendos në burgim. Ky arrestim provokoi një reagim shumë të fuqishëm nga aktorët vendorë dhe ata ndërkombëtarë, të cilët kërkuan lirimin e saj sa më shpejt të ishte e mundur. Ana Lalic u lirua një ditë pas marrjes në pyetje, ndërsa akuzat kundër saj u tërhoqën në fund të prillit. Ky incident jo vetëm që shkaktoi një efekt drithëruese tek qytetarët dhe ata që flisnin për çështje të caktuara me interes publik, por edhe i dha udhë një fushate përbaltje kundër Ana Lalic, e vënë në zbatim kryesisht nga media pro qeveritare. Gjithashtu, Civil Rights Defenders i bëri thirrje qeverisë së Serbisë të sigurojë hapësirë që gazetarët të marrin informacion dhe të informojnë qytetarët rreth zhvillimeve të vazhdueshme lidhur me COVID-19. “Besojmë se nuk ka asnjë justifikim për pezullimin e të drejtës së gazetarëve për të bërë pyetje në një forum të hapur dhe publik, kur merren në konsideratë mundësitë që ofron teknologjia moderne për të arritur këtë ndërveprim pa prani fizike”, thanë ata.²³

Në përgjithësi, gazetarët dhe aktivistët u ofenduan shpesh në internet gjatë pandemisë. Ofendimet erdhën nga media të tjera, zyrtarë publikë, ndonjëherë nga aktorë anonimë, dhe të gjithë këto bënë që ushtrimi i lirisë së shprehjes në serbi të binte në një nivel të ulët, megjithëse Serbia është në vendin më të ulët (vendi i 93-të) nga të katër vendet e trajtuara në këtë raport sipas Reporterëve Pa Kufi, dhe vlerësohet si një vend jo i sigurt për gazetarët.²⁴ Në një incident tjetër, gazetarja shqiptare Sonila Meço u abuzua në internet pasi kishte postuar një koment në Facebook që kritikonte deklaratat e bëra nga një mjek i vetëm për shtetasit shqiptarë që ishin bllokuar në kufirin me Greqinë fqinje dhe nuk po lejoheshin të hynin në vend.²⁵ Në mes të marsit, qytetarët e Shqipërisë morën një mesazh të papritur telefonik përmes operatorit të telefonisë së lëvizshme Vodafone, në të cilin Kryeministri Edi Rama i këshillonte të lanin duart për të luftuar koronavirusin dhe “të mbronin veten nga media”.²⁶

Por aktivistët, gazetarët dhe qytetarët nuk vuajtën vetëm në Serbi dhe Shqipëri kur u shprehën në internet. Në Bosnje dhe Hercegovinë, pati raste qytetarësh që u gjobitën sipas një vendimit të kundërshtuar, kryesisht në lidhje me postimet e tyre në rrjetet sociale.²⁷ Për shembull, një mjek u gjobit kur tha se spitalet nuk kishin mjete të mjaftueshme, u pretendua se një person nga Gradiska “shkaktoi panik dhe kreu sjellje të parregullt gjatë një situatë emergjence” dhe ofendoi organet publike të entitetit të RS-së, etj.

21 COVID-19: ndërhyrja politike në mediat në Kosovë, Federata Evropiane e Gazetarëve, 4 prill 2020

22 M. Milojevic, Parandalimi i përhapjes së panikut ose ‘disiplinimi’ i mjekëve dhe gazetarëve, Radio Free Europe/Radio Liberty, 12 prill 2020

23 Autoritetet e Serbisë Duhet të Respektojnë Liritë e Medias dhe të Drejtën e Qytetarëve për Informacion, Civil Rights Defenders, 11 prill 2020

24 Reporters without borders, Serbia

25 Shqipëri: gazetarja Sonila Meço përballet me furi abuzimi pas postimit në Facebook, Hartëzimi i Lirisë së Medias, 7 prill 2020

26 G. Erebara, Rama e Zhvendos Luftën me Median në Telefonat e Shqiptarëve, Balkan Insight, 13 mars 2020

27 Digital Rights in the Time of COVID-19, BIRD

MBIKËQYRJA

Në një raport të kohëve të fundit Freedom House theksoi se ndër prirjet shqetësuese sa i përket masave të marra gjatë krizës së Covid-19, është mbledhja në shkallë të gjerë e të dhënave shumë të ndjeshme personale dhe vënia në funksion e teknologjive ndërhyrëse për monitorimin e qytetarëve, si policimi parashikues, identifikimi automatik i fytyrave, apo skanimi termal.²⁸ Për më keq, këto masa shpesh u zbatuan pa mekanizma të përshtatshëm mbrojtës për parandalimin e abuzimeve me të drejtat e njeriut.

Pandemia e Covid-19 i shtyu shtetet e Ballkanit Perëndimor të përdorin edhe masa të shtuara mbikëqyrje, sepse u krijua një atmosferë sipas të cilës mendohej se e vetmja mënyrë për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së sëmundjes është mbikëqyrja strikte e sjelljes së qytetarëve. Kufizimet e lëvizjes dhe mbylljet, që në disa raste zgjatën me ditë të tëra pa ndërprerje, kishin gjithashtu për qëllim të kontrollonin tubimet dhe grupimet e mëdha.



Për shembull, qytetarët shqiptarë duhet të merrnin leje në portalin E-Albania për të dalë nga shtëpitë e tyre për të blerë ushqimet apo për të shëtitur kafshët shtëpiake.²⁹ Vetëm një pjesëtar i familjes mund të merrte lejen e ditës, e cila lejonte lëvizje për një periudhë prej dy orësh. Gjithashtu, në kryeqytetin shqiptar të Tiranës, policia përdorin dronët për të gjurmuar respektimin e masave të mbylljes.³⁰

28 A. Shahbaz, A. Funk, Kura e Rreme: Mbikëqyrje Abuzive në Emër të Shëndetit Publik, Freedom House, 2020

29 M. Brändle, T. Brankovic, A. Dyrishi, Demokracia dhe Gjendja e Jashtëzakonshme, Fondacioni Friedrich Ebert, 18 maj 2020

30 Policia Shqiptare Përdor Dronët për Zbatimin e Mbylljes, Zëri i Amerikës, 16 prill 2020

Në Serbi, ku gjendja e jashtëzakonshme u shpallë në mes të marsit dhe zgjati deri në fillim të majit, Presidenti i Serbisë paralajmëroi qytetarët gjatë një konference për shtyp të mbajtur pak pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, duke iu referuar gjurmimit të vendndodhjes së telefonave të lëvizshëm, se “numrat e telefonave italianë po gjurmohen” për shkak se shumë qytetarë serbë po ktheheshin në vend nga jashtë dhe duhet të zbatonin urdhrat e detyrueshëm të vetëizolimit.³¹ Ai tha gjithashtu se ka një “metodë tjetër” për gjurmimin e lëvizjes së atyre që lënë telefonat diku për të “gënjyer qeverinë”, por nuk dha shpjegime se cila ishte kjo metodë.

Masat e shtuara të mbikëqyrjes, që më së shumti kishin të bënin me lëvizjen e qytetarëve, pengojnë punën e gazetarëve, aktivistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, sidomos në hapësirat publike, të cilat gjithmonë e më shumë po kthehen në zona kontrolli distopik.³² Mbase kur pandemia të ketë kaluar, instrumentet e avancuara teknologjike të përdorura për të ndaluar përhapjen e virusit, mund të përdoren për qëllime të tjera, si për shembull për kufizimin e kundërshtimit dhe kritikave kundër qeverisë.³³

Në kryeqytetin e Serbisë, Beograd, po instalohet një sistem masiv i mbikëqyrjes me video, i përbërë nga mijëra kamera me mundësi për të identifikuar automatikisht fytyrat. Ky është një paralajmërim serioz për aktivizmin shoqëror dhe punën në interesin publik, sepse mbulimi i rrugëve të një qyteti të tërë me mbikëqyrje inteligjente me video ndryshon rrënjësisht shoqërinë.³⁴



Sistemi i mbikëqyrjes inteligjente me kamera është instaluar në Beograd në kundërshtim me standardet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kufizon të drejtat dhe liritë në mënyrë joproporcionale dhe pa kriter. Qëllimi i tij nuk është përcaktuar qartë, dhe nuk është përcaktuar as edhe një kuadër i qartë dhe strikt ligjor përpara zbatimit të tij, për përdorimin e sistemit të mbikëqyrjes inteligjente në hapësira publike nga ana e policisë. “Qyteti Inteligent”, një projekt i përbashkët i autoriteteve publike serbe dhe shoqërisë kineze Huawei, po zhvillohet në mënyrë jo transparente me kufizime informacioni lidhur me kushtet e partneritetit dhe çmimin e sistemit në tërësi. Nuk ka pasur debat publik mbi ndikimin e mundshëm shoqëror dhe politik të këtyre teknologjive tejet ndërhyrëse.³⁵ Është raportuar për mbikëqyrje ndërhyrëse me video edhe në Republikën Srpska, një nga entitetet e Bosnje dhe Hercegovinës. Sipas raportimeve në media, Ministria e Brendshme e Republikës Srpska ka blerë më shumë se 300 kamera, nga të cilat 66 kanë aftësi të identifikimit të fytyrës.³⁶

31 Përgjigja e Qeverisë kundër COVID-19 ndikon negativisht të drejtat digjitale në Ballkan, International Freedom of Expression Exchange, 4 prill 2020

32 T'i jepet fund mbikëqyrjes masive biometrike!, European Digital Rights, 13 maj 2020

33 Dita pas pandemisë: po shkojmë drejt një distopie mbikëqyrjeje, Fondacioni SHARE, 2 prill 2020

34 Faqja e Internetit e Mijëra Kamerave: <https://hiljade.kamera.rs/en/home/>

35 Është kundër ligjit dhe e dëmshme për shoqërinë të futet sistemi i mbikëqyrjes inteligjente në Beograd, Thousands of Cameras

36 Ministria e Brendshme vendosi kamera për identifikimin e fytyrës: Ku do të mbikëqyrëmi të gjithë?, Istok, 28 qershor 2020

Ndërkohë që shoqëritë u zhvendosën gjithmonë e më shumë në internet, mbrojtësit e të drejtave të njeriut u përballën me një sërë pengesash në punën e tyre. Në një sërë rastesh, gazetarët u përballën me problem serioze gjatë rolit të tyre si mbikëqyrës, sepse ky rol nuk mund të kryhet tërësisht në internet, duke qenë se kërkon edhe raportim nga terreni. Kështu, shoqatat e gazetarëve ngulën këmbë që gazetarët të përjashtoheshin nga shtettrrethimi. Në Serbi, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës i kërkoi autoriteteve që në fillim të gjendjes së jashtëzakonshme, të qartësojnë kushtet për lëvizjen e gazetarëve gjatë periudhës së mbylljes.³⁷ Si përfundim, gazetarët profesionistë u lejuan të raportojnë nga terreni nëse ata aplikonin për këto leje. Megjithatë, ky kusht nuk përfshinte gazetarët qytetarë, ata që shkruanin në blog dhe të tjerë pa akreditim si gazetarë, kështu që për ta puna nga distanca u kthye në kufizim.

Që prej fillimit të vitit në Shqipëri ka pasur një sërë protestash, si prishja e tubimit përkujtimor në Ditën e Evropës, i organizuar nga shoqëria civile më 9 maj, si dhe protesta kundër shembjes së Teatrit Kombëtar, një protestë masive anti-qeveritare që u shpërnda me forcë dhe ku 37 persona u arrestuan me një gazetar mes tyre. Megjithatë, me shumë gjasa, protesta më shqetësuese ishte ajo e mesit të dhjetorit kundër vrasjes së një të riu nga ana e policisë, që rezultoi në dhunë në rrugë dhe në përndjekjen penale të më shumë se 300 qytetarëve, si dhe në arrestimin e dhunshëm të tre gazetarëve.³⁸ Këto raste dhune shkelin qartë të drejtën e organizimit të lirë në Shqipëri dhe shkaktojnë një efekt drithërues gjatë krizës.

Për më tepër, një redaktor në Kosovë u arrestua për shkeljen e shtettrrethimit, megjithëse në fakt ajo po ushtronte profesionin e saj.³⁹ Kryeredaktorja e portalit të lajmeve Kossev, Tatjana Lazarevic, ishte në krye të detyrës kur ajo u arrestua, dhe megjithëse ajo u lirua shpejt, një incident i tillë mund të kishte shkaktuar një efekt drithërues serioz jo vetëm te gazetarët e tjerë, por edhe te të gjithë ata që në kuadër të punës së tyre duhet të vëzhgonin situatën në terren. Në fund, Ministrinë e Punëve të Brendshme në Kosovë sqaroi se shtettrrethimi nuk zbatohet për gazetarët dhe profesionistët e medias, por nuk ishte e qartë nëse edhe aktivistët që mbronin të drejtat e njeriut ishin të përjashtuar nga shtettrrethimi.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, Institucionit të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut iu desh të reagonte kur puna e mbrojtësve të të drejtave të njeriut u pengua gjatë krizës.⁴⁰ Më konkretisht, në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës, konferencat për shtyp të Qendrës së Krizës mbaheshin me një numër të kufizuar gazetarësh ose pa praninë fizike të tyre, ose zyrtarët i jepnin përgjigje vetëm pyetjeve të dorëzuara paraprakisht me postë elektronike. Kështu, Institucioni i Avokatit të Popullit në Bosnje dhe Hercegovinë shpalli një rekomandim të përgjithshëm ku i bënte thirrje autoriteteve të siguronin sa më shumë të ishte e mundur praninë e gazetarëve në konferencat për shtyp.

Një situatë e ngjashme u vu re edhe në Serbi.⁴¹ Në një moment të caktuar shumica e mediave lejoheshin vetëm të dërgonin pyetjet me postë elektronike përpara konferencave ditore për shtyp të mbajtura nga Stafi i Krizës. Ky nuk ishte një ndalim i hapur që gazetarët të mos merrnin pjesë në konferencat për shtyp, megjithëse vetë transmetuesi publik RTS dhe Agjencia Shtetërore e Lajmeve Tanjug kishin kamera në konferencë, ndërsa pyetjet e dorëzuara nga gazetarët të veçantë shmangeshin tërësisht. Kjo nuk i lejonte gazetarët të përmbushnin rolin e tyre si mbikëqyrës dhe puna e tyre në distancë dukej si e detyruar jo vetëm nga pandemia, por edhe nga autoritetet.⁴²

PROBLEMATIKAT ME KAPACITETET

Ashtu si edhe në sektorë të tjerë, pandemia i përballi mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrës të tjerë të interesit publik me një situatë të pahasur më parë, veçanërisht kur bëhet fjalë për ata që punonin në komunitete të vogla. Duke marrë në konsideratë kapacitetet e tyre afatshkurtra dhe afatgjata “normaliteti i ri” duket si një sfidë e gjatë për sektorin civil kur bëhet fjalë për qëndrueshmëri. Ngritja e një organizate dhe frymëzimi i njerëzve që të përfshihen në aktivizëm shoqëror vështirësohen në kohë krize, veçanërisht për shkak të trysnive ekonomike.

Kapacitetet financiare, teknike dhe organizative të shoqërisë civile varen shumë nga grantet dhe projektet. Kultura e financimit nga publiku i gjerë nuk është zhvilluar ende në Ballkanin Perëndimor, dhe ka gjasa të mos ketë organizata të shoqërisë civile në rajon ku pjesa më e madhe e të ardhurave të tyre vjen nga dhurimet e vogla dhe kuotizacionet. Megjithatë, për shkak të efekteve negative të pandemisë në ekonominë botërore, është e pritshme që vlerat e donacioneve nga entitete të vendeve të huaja, si ambasadat dhe agjencitë për zhvillim të ulen. Në këto rrethana, do të jetë e vështirë të sigurohet rritje e mjaftueshme për sektorin qytetar dhe të aktivizimit, kur merren parasysh fondet dhe burimet e kufizuara.

Për shembull, CIVICUS, që është një rrjet ndërkombëtar i organizatave të shoqërisë civile, botoi një letër të hapur për donatorët dhe mbështetësit në mars 2020, duke kërkuar sa më shumë fleksibilitet, siguri dhe stabilitet lidhur me grantmarrësit dhe partnerët gjatë krizës së Covid-19.⁴³ Letra rendiste një sërë mënyrash për ta arritur këtë:

Dëgjoni partnerët grantmarrës dhe eksploroni së bashku si mund t'i ndihmoni të përballen me krizën, duke besuar se ata e dinë më mirë se për çfarë kanë nevojë në kontekstet e tyre;

Inkurajoni rikonceptimin dhe ripërcaktimin e afateve të veprimtarive dhe produkteve të planifikuara, dhe siguroni udhëzime të qarta për marrjen e miratimeve përkatëse për këto ndryshime;

Mbështesni mënyra të reja dhe krijuese për krijimin e një kulture solidariteti dhe ndërveprimi, ndërkohë që respektohet distancimi fizik dhe masat e tjera parandaluese;

Ofroni më shumë fleksibilitet duke marrë përsëri në konsideratë kështet e pagesave bazuar në nevoja faktike, duke i kthyer grantet e projekteve ekzistuese në fonde të pakufizuara, ose duke shtuar fonde shtesë për të ndihmuar në krijimin e rezervave për mbulimin e kostove të paparashikuara;

Thjeshtoni procedurat dhe afatet e raportimit dhe aplikimit, në mënyrë që grupet e shoqërisë civile të organizojnë më mirë kohën, energjinë dhe burimet e tyre për të mbështetur grupet më të cenuara, në vend që të përmbushin kërkesat strikte të raportimit dhe kontrollit të duhur.

Një nga shqetësimet kryesore për organizatat e të drejtave të njeriut dhe sektorin qytetar në përgjithësi lidhet me infrastrukturën teknike, si faqet e tyre të internetit, serverat, postën elektronike, pajisjet e punës, etj. Më konkretisht, përvoja e Fondacionit SHARE në ofrimin e mbështetjes teknike dhe trajnimeve pa pagesë, ka treguar se shumë organizata kanë burime të kufizuara kur bëhet fjalë për aspektin e TI-së së punës së tyre, çka do të thotë se ata shpesh nuk kanë staf të TI-së dhe mbështeten tek bashkëpunues të jashtëm për të menaxhuar infrastrukturën e tyre. Në rrethana si ajo e pandemisë, të cilat shkaktojnë ndryshime radikale në shoqëri dhe në mënyrën e veprimit të organizatave, një sulm kibernetik në shkallë të gjerë mund të ketë pasoja shkatërrimtare për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, si pasojë e mungesës së stafit dhe kapaciteteve të duhura teknike për të zbutur sulmin dhe për të riparuar dëmin e shkaktuar prej tij. Kjo mund të çojë në humbjen e të dhënave me vlerë që janë mbledhur gjatë viteve të tëra të punës, ose për shembull humbjen e aksesit në llogaritë e mediave sociale apo postës elektronike të organizatës. Puna nga shtëpia mund të përbëjë gjithashtu rrezik për sigurinë digjitale, sepse masat e sigurisë që punonjësit marrin në banesën/pajisjet e tyre private mund të mos jenë në të njëjtin standard me ato të organizatës.

⁴³ Letër e Hapur: Donatorët dhe mbështetësit duhet të veprojnë për të siguruar qëndrueshmërinë e shoqërisë civile gjatë pandemisë së COVID-19, CIVICUS, 19 mars 2020

³⁷ NDNV: Mundësojini gazetarëve të punojnë edhe gjatë shtettrrethimit, Danas, 18 mars 2020

³⁸ Autoritetet shqiptare duhet të parandalojnë dhunën e mëtejshme dhe të respektojnë të drejtën e lirisë së organizimit të paqshëm, Këshilli i Evropës, 15 dhjetor 2020

³⁹ Të Drejtat Digjitale në Kohën e COVID-19, BIRD

⁴⁰ M. Brändle, T. Brankovic, A. Dyrnishi, Demokracia dhe Gjendja e Jashtëzakonshme, Fondacioni Friedrich Ebert, 18 maj 2020

⁴¹ Nuk ka gazetarë në konferencat ditore, thotë qeveria serbe, N1, 10 prill 2020

⁴² Liria e shtypit nuk duhet të rrezikohet nga masat për të kundërshtuar keqinformimin në lidhje me COVID-19, Këshilli i Evropës, 3 prill 2020

KËSHILLA DIGJITALE

Tek përballen me pandeminë botërore, aktivistët dhe organizatat në të gjithë botën janë detyruar të zhvendosin pjesën më të madhe të komunikimit dhe bashkëpunimit të tyre në hapësirën digjitale. Megjithëse 20 vitet e fundit ka pasur një zhvillim të shpejtë në digjitalizimin e shumë proceseve të jetës së përditshme, duket sikur gjithçka ishte në përgatitje të tranzicionit tejte të shpejtë që ndodhi në vetëm disa javë pas përcaktimit të karantinave të detyrueshme në të gjithë botën.

Këto ndryshime të befasishme u ndoqën nga vendime në dukje të logjikshme, por të nxituara, lidhur me zgjedhjen e teknologjive, shërbimeve dhe programeve kompjuterike që duhet të kompensonin kufizimet e reja dhe distancimin fizik. Është e kuptueshme të pranohen zgjidhje që janë të njohura dhe të lehta në përdorim, por çështja është sa ato përmbushin kriteret e nevojshme për punë të sigurt nga ana e aktivistëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Për më tepër, zgjedhjet që bëjmë tani do të ndikojnë shumë teknologjitë që do të pranohen nga organizatat dhe shoqëria në tërësi në periudhën afatgjatë, kështu që çështja e dytë është me etike në natyrë: a duam të përdorim shërbime të zotëruara (tregtare) që krijojnë fitime, apo zgjidhje 'open source' të ndikuara nga komuniteti, dhe si ndikohet diversifikohet dhe decentralizohet ekosistemi digjital nga kjo.

Zgjedhja dhe të kuptuarit e teknologjive që aktivistët i përdorin gjatë punës së tyre kanë një ndikim kyç në integritetin dhe sigurinë e tyre, në aftësinë ripërtëritëse të organizatave të tyre dhe në



qëndrueshmërinë e shoqërisë që po ndërtojmë.

Për shkak të natyrës së punës së tyre, aktivistët e të drejtave të njeriut janë më të ekspozuar ndaj thyerjeve të sigurisë së informacionit, ndaj mbikëqyrjes më të madhe dhe interceptimit më të shpeshtë të komunikimeve, ndaj përpjekjeve për censurim përmes sulmeve teknike, qasjes së paautorizuar dhe kompromentimit të të dhënave personale, ndaj kërcënimeve, trysnive dhe metodave të tjera që kanë për qëllim të kufizojnë lirinë e shprehjes dhe të pengojnë punën e tyre. Rezistenca ndaj këtyre kërcënimeve në hapësirën digjitale varet nga teknologjitë që përdorim.

Fatkeqësisht, shumica e mjeteve në të cilat mbështetemi sot janë krijuar nga shoqëri me modele biznesi që bazohen në mbledhjen e të dhënave dhe sjelljeve personale të përdoruesve të tyre dhe nxjerrjen e fitimit prej tyre. Tashmë ne e dimë mirë që jemi pjesë e "ekonomisë së mbikëqyrjes", por ne vazhdojmë të përdorim këto mjete, sepse të gjithë të tjerët i përdorin ato dhe është e lehtë të mbështetemi tek to.

Megjithatë, nga pikëpamja teknike, e meta kryesore e shërbimeve dhe aplikacioneve më tregtare dhe të njohura është se kodi i tyre është i mbyllur. Kodi i mbyllur (i zotëruar) mund të krahasohet me një

kuti të zeze në të cilën ne nuk e dimë se çfarë po ndodh dhe se ku shkojnë të dhënat tona, ndërkohë që ne i përdorim me besim këto mjete, kur në të njëjtën kohë kemi pak ose aspak besim për korporatat. Ky kompromis që jemi të gatshëm të pranojmë për të përdorur teknologjinë pa u lodhur, mund të jetë shumë i rrezikshëm. Përveç shkëmbimit të të dhënave të përdoruesve për qëllime tregtare, është provuar se shërbimet e sigurisë mund të interceptojnë komunikimet shumë lehtë dhe të kenë qasje të drejtpërdrejtë në metodatat tona. Përmes përdorimit të mjeteve moderne për spiunazh kibernetik qeveri në të gjithë botën kryejnë sulme të shënjestruara kundër disidentëve politikë dhe shpesh punësojnë piratë keqbërës, të cilët me metodat e sofistikuar teknike dhe inxhinierinë shoqërore, arrijnë të depërtojnë në sisteme të mbrojtura mira pa u vënë fare re. Së fundmi, parehatia që e njohim mirë kur disa prej shërbimeve të njohura që përdorim nuk janë në funksion për pak kohë, ngre çështjen se si do të ndihemi kur ato nuk janë në funksion për një kohë të gjatë, sepse nuk bëhet më fjalë nëse diçka e tillë do të ndodhë, por kur do të ndodhë.

Nga ana tjetër, zbatimi dhe përdorimi i zgjidhjeve open source tërësisht të përgjegjshme dhe të sigurta, shpesh kërkon më shumë përpjekje dhe burime. Për disa shërbime, është e nevojshme të punësohen inxhinierë për instalimin e tyre, duhet të kesh në pronësi ose të marrësh serverë me qira, duhet mirëmbajtur i gjithë sistemi, duhet trajnim shtesë, dhe shumë organizata nuk i kanë këto kapacitete. Megjithatë, investime të tilla mundësojnë më shumë kontroll mbi rrjedhën e të dhënave, sigurinë e tyre dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemeve të informacionit. Në ditët e sotme, një organizatë duhet ta shohë teknologjinë si të barabartë me menaxhimin, financat, apo burimet njerëzore.

Kur këto çështje merren në konsideratë, dhe duke marrë në konsideratë edhe burimet e disponueshme, individët dhe organizatat mund të vendosin se si do t'i qasen teknologjisë dhe zgjedhjes së mjeteve me të cilat punojnë. Kjo shkallë mund të jetë zbutje, pra ulje e rrezikut që arrihet me hapa të vegjël për përmirësimin e mjedisit teknologjik, si zëvendësimi i disa mjeteve të caktuara për të cilat ka alternativa të verifikuara dhe që kërkojnë pak përpjekje për arritjen e tranzicionit. Kjo qasje nuk i zgjidh problemet, por i pakëson ato, lehtëson kuptimin e teknologjisë dhe rrit besimin për zgjedhje dhe vendime më të mëdha në të ardhmen. Një shkallë më ambicioze mund të jetë një ndryshim i plotë i qasjes ndaj teknologjisë. Kjo kërkon investime më serioze burimesh, kohe dhe energjie, por në terma afatgjatë sjell shumë më tepër pavarësi në kontrollin e të dhënave, si dhe ndryshim madhor sistematik dhe tekniko-politik.

Më poshtë jepet një panoramë e disa prej mjeteve dhe zgjidhjeve më gjithëpërfshirëse që aktualisht ofrohen nga komuniteti, dhe të cilat mund të garantojnë komunikim dhe punë në ekip të sigurt, jo vetëm gjatë krizës por edhe në të ardhmen.

Komunikim i çastit (alternativa për WhatsApp, Facebook, Messenger, Viber, etj.)

Signal - Një aplikacion komunikimi që gjendet në shumicën e platformave sistemeve operative dhe një projekt pionier në komunikimin e koduar të çastit. Mundëson dërgimin e mesazheve, edhe në grup, me zë, dhe ndarjen e fotove dhe videove. Kohët e fundit ka shtuar edhe telefonata me zë dhe video. Shërben edhe si zëvendësim për aplikacionet e SMS/MMS-ve, por kërkon që të gjitha palët ta përdorin me qëllim zëvendësimin e protokolleve me protokollet e veta. Është projekt open source, i zbatuar nga një organizatë jofitimprurëse dhe financohet tërësisht nga donacionet, çka i lejon të funksionojë pa pasur nevojë të shesë të dhënat e përdoruesve. Gjatë periudhës së zhvillimit të tij, është përdorur më së shumti nga aktivistët në të gjithë botën për të siguruar komunikimin e tyre në regjime shtypëse, ose në situata me mbikëqyrje të shtuar policore, si gjatë protestave në shoqëritë demokratike.

Wire - Një nga homologët më të njohur të Signal-it, që është krijuar paralelisht me të dhe me disa përparësi që shërbime të tjera nuk i kishin në atë kohë, si biseda të koduara në grup, apo një mundësi për t'u regjistruar dhe përdorur shërbimin pa dhënë një numër telefoni. Ofrimi i këtyre mundësive të veçanta që janë të orientuara drejt privatësisë së shtuar krahasuar me konkurrencën, ka qenë shumë e rëndësishme për avancimin e teknologjisë dhe diversitetin e të gjithë ekosistemit. Duke qenë se edhe Wire është open source dhe nuk shet të dhënat e përdoruesve të vet, metoda e vet e financimit bazohet në ofrimin e shërbimeve të shtuara për përdoruesit e biznesit.

Telegram - Megjithëse nuk është një platformë tërësisht open source (kodi i aplikacionit është i hapur, ndërsa nuk dihet se çfarë ndodh në serverët e shoqërisë) deri tani nuk ka pasur incidente të evidentuara të kompromentimit të të dhënave të aktivistëve në Telegram, dhe shërbimi është një prej shërbimeve më të njohura për komunikimin e sigurt, të paktën kur bëhet fjalë për shkëmbimin e informacionit ndërmjet grupeve të mëdha të njerëzve përmes grupeve dhe kanaleve. Është pikërisht për shkak të kësaj lehtësie në komunikim në shkallë të gjerë, të ndërfaqes së thjeshtë dhe njohjes së gjerë në publikun e gjerë, që Telegrami shihet shpesh si një alternativë për aktivistët e të drejtave të njeriut. Megjithëse platforma ka ndërtuar një marrëdhënie besimi me përdoruesit e vet, këshillohet kujdes sepse sistemi nuk është tërësisht open source, modeli i biznesit nuk është tërësisht i qartë dhe nuk ka garanci për qëndrueshmëri afatgjatë.

Konferenca në internet/me video (Alternativa ndaj Zoom, Skype, Google Meet, Microsoft Teams, etj.)**Jitsi Meet**

Shumë organizata dhe aktivistë po përdorin Jitsi Meet si platformën parësore për telefonatat me video gjatë viteve të fundit, për një sërë tiparesh kyçe. Ajo ishte një ndër platformat e para që zbatoi shërbim të koduar të këtij lloji dhe që është open source, dhe në të njëjtën kohë është një shërbim që nuk kërkon instalimin e aplikacioneve të veçanta, por punon nga të gjithë shfletuesit e njohur të internetit përmes klikimit në një adresë. Për organizatat me më shumë burime, platforma mund të shkarkohet dhe të instalohet në serverat e tyre Linux, çka ofron një nivel sigurie shtesë.

BigBlueButton

Përparësia konkurruese e Zoom në botën e mjeteve të konferencave video të zotëruara dhe tregtare, arrihet më së miri nga BigBlueButton në botën e teknologjive të hapura dhe të përgjegjshme. Platforma ka shumë tipare që plotësojnë nevojat për aktivitete të mëdha publike në internet, si administrim të përdoruesve, ndarjen e përmbajtjeve multimediale, paraqitjen e prezantimeve, mjete bashkëpunimi si tabela dhe tabela me "letër", etj. Kërkesa e vetme është instalimi i kopjes tuaj në serverat Linux, ose përdorimi i kopjes së një organizate tjetër, e cila mund të vërë në dispozicion për përdorim, çka po ndodh gjithmonë e më shumë në sektor.

Komunikim në ekip (alternativa ndaj Slack, Microsoft Teams, Discord, etj.)**Mattermost**

Organizatat me shumë komunikim dhe materiale të brendshme shpesh mbyten dhe humbin në korrespondencën përmes postës elektronike. Platforma si Mattermost janë mjete që kanë mundësi të lehtësojnë barrën e kutive të postës elektronike të mbushura plot dhe të përmirësojnë komunikimin përmes kanaleve tematike, kërkimit intuitiv, indeksimit dhe ndarjes së sigurt të dokumenteve dhe materialeve të tjera. Pas instalimit fillestar në serverin e zotëruar apo të marrë me qira nga organizata, nuk kërkohet shumë mirëmbajtje dhe administrim, kështu që është i rehatshëm për organizata me kapacitete më të vogla teknologjike. Të gjitha të dhënat janë të koduara dhe projekti financohet përmes ofrimit të mbështetjes dhe shërbimeve shtesë për përdoruesit e biznesit.

Element

Deri së fundmi i njohur me emrin "Riot.im", Element është një klient për chat që përdor protokollin modern Matrix, një protokoll i federuar komunikimi që është krijuar si një standard i hapur dhe që synon të mundësojë ndërfunksionalitetin midis shërbimeve të ndryshme të chatit dhe konferencave me video. Kjo do të thotë që mesazhet mund të shkëmbehen me përdoruesit e shumicës prej platformave të njohura, përfshirë shërbime të zotëruara si Apple iMessage, Facebook Messenger, WhatsApp, Discord, Slack dhe patjetër aplikacionet open source si Signal, Mattermost, IRC, Telegram ...

Mjete të tjera

Në varësi të nevojave të organizatës, duhen përmendur disa mjete të tjera të mira që mund të përdoren si alternativa për shërbimet e shoqërive të mëdha që mbledhin të dhëna.

Etherpad është një program shkrimi në internet për bashkëpunim në kohë reale (alternativë për Google Docs) që mund të instalohet në serverin tuaj, por ka edhe programe falas në internet si "**Riseup Pad**" që ofron shërbimin falas, dhe nuk mbledh adresat IP dhe respekton privatësinë e përdoruesit. Aplikacioni mund të hapet edhe përmes një shërbimi VPN apo **Shfletuesi Tor**, përdorimi i të cilave është i rëndësishëm për maskimin e veprimtarisë në internet.

E njëjta teknologji që përdoret nga Tor për lidhjet e veta, përdoret edhe nga **OnionShare**, një shërbim i sigurt për ndarjen e materialeve. Me pak fjalë të thjeshta, shërbimi punon duke krijuar adresa të koduara dokumentesh në një kompjuter që përdoruesi në anën tjetër mund t'i hapë vetëm duke përdorur protokollin Tor.

Së fundmi, kur bëhet fjalë për magazinimin e sigurt të të dhënave dhe shërbimet alternative "cloud" (zëvendësime për Dropbox apo Google Drive), në pararojë është Nextcloud. Ai kërkon instalim dhe mirëmbajtje të serverat e vetë organizatës, që domosdo kërkon burime shtesë, por gjithashtu ofron nivelin më të lartë të kontrollit të të dhënave.

Në fund të fundit, këto mjete dhe vënia e tyre në zbatim në punën e përditshme nuk siguron imunitet të plotë kundër rreziqeve të sigurisë, por ato na japin më shumë pavarësi dhe inkurajojnë më shumë botëkuptim të teknologjisë. Rezistenca e individëve dhe organizatave të tyre varet më tej nga botëkuptimi për ekosistemin e hapësirës digjitale dhe marrëdhënien e teknologjisë me shoqërinë. Për këtë arsye është e rëndësishme që përveç pranimit të mjeteve të përgjegjshme, të kuptojmë edhe rrjedhën e të dhënave, arkitekturën e mbikëqyrjes, dhe modelet e biznesit të korporatave të teknologjisë që po centralizojnë gjithmonë e më shumë internetin me kolonizimin modern të hapësirës digjitale. Të kuptuarit dhe të pranuarit e teknologjive të përgjegjshme inkurajon zhvillimin e alternativave, ndërsa njohuritë e shtuara të komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi inkurajon lirinë, hapjen dhe decentralizimin e internetit, që është kthyer në parakusht për rezistencën e demokracisë.

Përfundimi

Në situatën aktuale, përpjekjet e qeverive për të zbatuar legjislacion kufizues dhe teknologji ndërhyrëse nën pretekstin e luftës kundër pandemisë, duhet të kontrollohen më shumë nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të cilët duhet të jenë edhe më vigjilent. Masat e marra në të ardhmen mund të kenë dispozita të cilat ndikojnë negativisht lirinë e shprehjes, të drejtën për privatësi dhe të drejta e liri të tjera përkatëse, si e drejta për të protestuar apo liria e organizimit, por ato mund të “grupohen” në mënyrë të tillë që i bën fillimisht të paqarta. Kështu, sektori qytetar duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm dhe të vërë në pikëpyetje të gjitha masat që duket sikur po merren për të frenuar përhapjen e koronavirusit, por që mund të sjellin mbikëqyrje të përhershme ose kufizime të tjera joproporcionale të të drejtave të njeriut.

Megjithëse rrethanat aktuale janë sfiduese për mbrojtësi e të drejtave të njeriut, aktivistët dhe sektorin qytetar në përgjithësi, ato mund të jenë edhe mundësi për të provuar mjete teknologjike alternative dhe më të sigurta, si programet falas dhe open source. Megjithëse tranzicioni në punë nga shtëpia dhe zbatimi i mjeteve të reja në infrastrukturën teknike të organizatës mund të sjellë disa vështirësi, këto veprime mund të sigurojnë fleksibilitet afatgjatë dhe rezistencë në kohë krize, veçanërisht për grupet dhe organizatat e vogla të cilat nuk kanë shumë burime për investim. Për shembull, Projekti Galileo u siguron mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe aktorëve të tjerë të interesit publik zbutjen e sulmeve teknike, parandalimin e cenueshmërisë ndaj abuzimit dhe mbrojtjen e integritetit të të dhënave.⁴⁴

Megjithatë, kur bëhet fjalë për punën në distancë, organizatat duhet të sigurojnë që punonjësit e tyre të praktikojnë të njëjtat standarde të sigurisë digjitale si në kushtet e zyrës. Për më tepër, një qasje më e hapur ndaj përdorimit të programeve falas dhe open source e ndihmon komunitetin të jetë më i prirur që interneti të jetë i hapur, i lirë dhe i decentralizuar.



⁴⁴ Për më shumë informacion rreth Projektit Galileo vizitoni: <https://www.cloudflare.com/en-gb/galileo/>



TË DREJTAT E NJERIUT

NË KOHË PANDEMIE

